



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 gusht 2020
Nr. ref.:RK 1607/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI19/20

Parashtrues

Lutfi Shantir

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në
Prizren CP. nr. 2739/2014, të 27 janarit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Lutfi Shantir nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren CP. nr. 2739/2014, të 27 janarit 2020.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, me të cilin sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 janar 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 30 janar 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzie Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 13 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë që përmbanin edhe ankesën e parashtruar në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren CP. nr. 2739/2014, të 27 janarit 2020 si dhe një kopje të aktvendimit në fjalë.
8. Më 21 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë të titulluara “parashtresë-urgjencë”.
9. Më 26 shkurt 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Themelore në Prizren.
10. Më 22 nëntor 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Nga shkresat e përfshira në kërkesë, rezulton se më 4 nëntor 2002, parashtruesi i kërkesës si pronar i agjencionit turistik "Express-tur" nga Prizreni, në cilësi të shitësit, kishte lidhur kontratë për shitblerjen e tre autobusëve, me çmim prej 55.000 euro, me NTU "Kosovatrans" nga Prizreni. Kontesti ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe NTU "Kosovatrans" kishte lindur për shkak të dyshimit se dokumentacioni për njërin prej autobusëve ishte i falsifikuar. Rrjedhimisht parashtruesi i kërkesës kishte paditur NTU "Kosovatrans" në Gjykatën Komunale në Prizren.
12. Më 23 maj 2004, Gjykata Komunale në Prizren me Aktgjykimin C. nr. 328/08 vendosi: (i) pjesërisht aprovohet kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës dhe obligohet pala e paditur NTU "Kosovatrans" nga Prizreni, që në emër të borxhit, parashtruesit të kërkesës t'ia paguaj shumën prej 27.000 euro me kamatë ligjore që fillon të rrjedhë nga dita e parashtrimit të padisë më 21.05.2003 deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm; (ii) pjesa e kërkesëpadisë nga shuma e gjykuar prej 27.000 euro dhe deri te shuma e kërkuar prej 28.000 euro, refuzohet si e pabazuar; dhe, (iii) obligohet pala e paditur NTU "Kosovatrans" nga Prizreni, që në emër të shpenzimeve gjyqësore parashtruesit të kërkesës t'ia paguaj shumën prej 500 euro, në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.
13. Gjykata Komunale kishte shpjeguar se kundërshtimet e palës së paditur NTU "Kosovatrans" se borxhin e mbetur prej 27.000 euro nuk ia ka paguar parashtruesit të kërkesës, sepse një autobus nga kontrata mbi shitblerjen është ndaluar nga shërbimi doganor në Podgoricë, sepse ka ekzistuar dyshimi se numri i shasisë ka qenë i falsifikuar, janë të pabazuara, sepse nga vendimi i shërbimit doganor në Podgoricë nr. 381/03-1-I, i 10 dhjetorit 2003, është vërtetuar se është ndërprerë procedura kundërvajtëse kundër RB, nga Prizreni, respektivisht vozitësit të NTU "Kosovatrans", dhe atij i është kthyer autobusi i markës "Mercedes" me regjistrimin 320-KS-013.
14. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës, në cilësi të kreditorit, kishte propozuar lejimin e përmbarimit të Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren C. nr. 328/08, të 23 majit 2004.
15. Më 22 shtator 2006, Gjykata Komunale në Prizren me Aktvendimin E. nr. 63/06, bazuar në aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Prizren C. nr. 328/08 të 23 majit 2004, lejoi ekzekutimin sipas propozimit të kreditorit (parashtruesi i kërkesës) kundër debitorit NTU "Kosovatrans" për pagesën e kërkesës në të holla në shumën prej 27.000 euro, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumën prej 500.00 euro, në emër të kamatës shumën prej 11.445.40 euro, në emër të përpilimit të propozimit për ekzekutim shumën prej 101,04 euro, në emër të shpenzimeve të ekspertit financiar 100,00 euro dhe në emër të shpenzimeve të procedurës së përmbarimit në shumën prej 442,50 euro, gjithsej shumën prej 39.588, 94 euro.

16. Në një datë të paspecifikuar, pala e paditur NTU "Kosovatrans" kishte kontestuar lejimin e përmbarimit të Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren C. nr. 328/08, të 23 majit 2004, me pretendimin se "çështja nuk është ndriçuar në tërësi".
17. Më 3 shtator 2007, Gjykata e Qarkut në Prizren me Aktvendimin Ac. nr. 277/2007, refuzoi ankesën e palës së paditur NTU "Kosovatrans" si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren E. nr. 63/06 të 6 marsit 2007. Gjykata e Qarkut në Prizren shpjegoi se pretendimi i debitorit NTU "Kosovatrans" se çështja nuk është ndriçuar në tërësi nuk mund të jetë objekt shqyrtimi në gjykatën e shkallës së dytë pasi që ekzekutimi është lejuar në bazë të titullit ekzekutiv përkatësisht aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Prizren C. nr. 328/08 të 23 majit 2004.
18. Më 3 shkurt 2010, Gjykata Komunale në Prizren me Urdhëresën E. nr. 63/06, urdhëroi Pro Credit Bank- filiala në Prizren që shumën e përgjithshme prej 43.563, 40 euro nga llogaria e debitorit NTU "Kosovatrans" ta bart në llogarinë e kreditorit (parashtruesit të kërkesës).
19. Gjykata vëren se nga dokumentet e përfshira në kërkesë, nuk mund të kuptohet se si janë zhvilluar të gjitha procedurat e ndryshme përmbarimore të propozimit për lejim të përmbarimit nga parashtruesi i kërkesës në njërën anë, dhe kundërshtimit të lejimit të propozimit për përmbarim nga pala e paditur NTU "Kosovatrans", në anën tjetër. Rrjedhimisht, përmbledhja e fakteve është paraqitur bazuar vetëm në dokumentet e përfshira në këtë kërkesë.
20. Më 27 janar 2020, Gjykata Themelore në Prizren me Aktvendimin CP. nr. 2739/2014, përcaktoi:

"I. URDHEROHET, kreditori i përmbarimit, Lutfi Shantir nga Prizreni, që në afatin prej 7 (shtatë) ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi, të parapaguaj deponoj në depozitën e kësaj gjykate, si organ përmbarues, sasinë e mjeteve monetare në shumën prej 150.00 € (një qind e pesë dhjetë) dhe atë në llogarinë e të hyrave gjyqësore-Këshilli Gjyqësor i Kosovës e nga e cila financohet gjykata si organ përmbarues dhe atë me nr. 1000 4300 7000 0518 CBK e në emër të mbulimit të shpenzimeve për ekspertizën ekonomike-financiare për llogaritjen e kamatës ligjore e cila fillon të rrjedh nga dita e parashtrimit të padisë me dt. 21.5.2003 e deri në pagesën definitive e për detyrimin në të holla në shumën e mbetur prej rreth 17.038.52 € e cila rrjedh nga dokumenti i përmbarimit-aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 328/03 i dt. 23.6.2004.

II. Në rast se pala kreditore, nuk i parapaguan shpenzimet në shumën e specifikuar dhe në afatin e caktuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata si organ përmbarues, do t'a pezulloj përmbarimin si dhe nuk do të kryhet veprimi konkret i përmbarimit e me përshkrimin e bërë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi".

21. Gjykata Themelore në Prizren me Aktvendimin e lartpërmendur shpjegoi se pala kreditore (parashtruesi i kërkesës) bazuar në nenin 13.1 të Ligjit Nr. 04/L-

139 për Procedurën Përmbartimore (në tekstin e mëtejshëm: LPP) lidhur me shpenzimet e ekspertizës për llogaritjen e kamatës ligjore dhe caktimin dhe kryerjen e përmbartimit duhet ta depozitoj shumën prej 150,00 euro (njëqind e pesëdhjetë).

22. Gjykata Themelore shpjegoi se: “ [...] në rastin konkret, sipas gjendjes së shkresave të lëndës, është e nevojshme që të caktohet ekspertizë gjegjëse financiare për të përcaktuar qartë kamatën ligjore për detyrimin gjegjës në të holla dhe se për këtë arsye edhe kjo gjykatë me aktvendimin e saj, CP. nr. 2739/20 14 të dt. 9.10.2019, ka urdhëruar palën kreditore, që të bëjë depozitim të mjeteve monetare në shumën prej 150,00 € në çështjen juridike të përmbartimit, CP. nr. 2739/2014 e më gjerësisht ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, por se pala kreditore, nuk e ka bërë depozitim të tyre”.
23. Gjykata Themelore më tej shtoi se bazuar në nenin 13.2 të LPP-së procedura e përmbartimit mund të pezullohet në rast se pala kreditore (parashtruesi i kërkesës) nuk i deponon mjetet e kërkuara për mbulimin e shpenzimeve të procedurës përmbartimore.
24. Gjykata Themelore në Prizren me Aktvendimin CP. nr. 2739/2014, deklaroi se pala e pakënaqur ka mundësi të parashtrojë ankesë “kundër këtij aktvendimi, lejohet ankesa brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, dhe përmes kësaj gjykate”.
25. Më 10 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit duke kërkuar që ankesa e tij të aprovohet në tërësi, kurse aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren CP. nr. 2739/2014, i 27 janarit 2020 të anulohet.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës nuk i referohet ndonjë dispozite kushtetues në veçanti, por nga kërkesa e tij rezulton se ai ankohet: (i) për mos përmbartimin e lëndës përmbartimore në dobi të tij çka ndërlidhet me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së; dhe (ii) se është diskriminuar për shkak se është pjesëtar i komunitetit pakicë në Kosovë çka ndërlidhet me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenit 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së.
27. Parashtruesi i kërkesës pretendon: “Kam dorëzuar fakte tash në ankesë se e kam fituar lëndën dhe kërkoj të ekzekutohet nga kjo gjykatë si organi më i lartë sepse është lënda e plotfuqishme. Këtu ka prova se është lënda e fituar në gjykatë më herët kundër “Kosovatrans” si debitor me numër të lëndës C. nr. 328/03”.
28. Parashtruesi i kërkesës pretendon: “Gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar padinë, kundër kësaj debitori ka ushtruar ankesë, edhe kjo ankesë është refuzuar, pas kësaj kanë marrë vendim të plotfuqishëm, mirëpo gjykata ende nuk e ka ekzekutuar lëndën, të cilën e kam fituar në Gjykatën e Qarkut në Prizren me numër Ac. nr. 277/2007, Gjykata është njëanshme për të pruar ekspertizë të re, ndërsa ekspertiza deri në 2013 është e plotfuqishme”.

29. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se si *“pjesëtar i komunitetit pakicë në Kosovë është diskriminuar”*.
30. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: *“kërkoj që kjo Gjykatë të ekzekutoj lëndën drejt kështu si është vendosur në këto vendime nga gjykata e Prizrenit. Sepse gjykata po i shkel të drejtat e mia”*.

Dispozitat relevante ligjore

LIGJI NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE

Neni 13

Shpenzimet e përmbarimit

1. Shpenzimet e procedurës lidhur me caktimin dhe kryerjen e përmbarimit paraprakisht i paguan kreditori.

2. Shpenzimet nga paragrafi 1. i këtij neni, propozuesi i përmbarimit ka për detyrë t'i parapaguaj brenda afatit të caktuar nga organi përmbarues. Organi përmbarues do ta pezulloj përmbarimin po qe se nuk parapaguhet shpenzimet brenda afatit të tillë. Po qe se brenda afatit të dhënë nga organi përmbarues nuk parapaguhet shpenzimet për kryerjen e një veprimi konkret, atëherë nuk do të kryhet vetëm veprimi i tillë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

31. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuar me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
32. Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

33. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], i cili përcakton:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

34. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili specifikon:

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar.”

35. Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës i obligon ata që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari duhet të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive në dispozicion në pajtim me ligjin, kundër një aktgjykimi ose vendimi të kontestuar.
36. Në këtë mënyrë, gjykatave të rregullta u jepet mundësia që të korrigjojnë gabimet e tyre përmes procedurave gjyqësore të rregullta para se rasti të vijë në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, që në legjislacionin vendës ka mjete juridike në dispozicion për t’u shfrytëzuar pranë gjykatave të rregullta në lidhje me shkeljen e pretenduar, pavarësisht nëse dispozitat e KEDNJ-së janë inkorporuar në të drejtën nacionale apo jo (shih, *inter alia*, *Aksoy kundër Turqisë*, paragrafi 51 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së të 18 dhjetorit 1996).
37. Parimi është se mekanizmi mbrojtës i krijuar nga Gjykata Kushtetuese të jetë subsidiar në raport me sistemin e rregullt gjyqësor që mbron të drejtat e njeriut (shih, ndër të tjera, *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 48 i aktgjykimit të GJEDNJ-së i 7 dhjetorit 1976).
38. Në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, parashtuesi i kërkesës duhet të ketë një rrugë të rregullt deri te mjetet juridike të cilat janë në dispozicion dhe të mjaftueshme për të siguruar një mundësi për të korrigjuar shkeljet e pretenduara. Ekzistimi i mjeteve juridike në fjalë duhet të jetë mjaft i sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, dhe nëse nuk është kështu, atëherë këtyre mjeteve juridike do t’iu mungojë disponueshmëria dhe efektiviteti i nevojshëm (shih, *inter alia*, *Vernillo kundër Francës*, paragrafi 27 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së i 20 shkurtit 1991, dhe *Dalia kundër Francës*, paragrafi 38 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së i 19 shkurtit 1998).

39. Gjykata duhet të shqyrtojë nëse janë shteruar mjetet juridike dhe nëse mjeti juridik ishte efektiv, në dispozicion në teori dhe praktikë në kohën përkatëse, përkatësisht, që ka qenë i qasshëm, që ka mundur t'i korrigjojë shkeljet në lidhje me kundërshtimet e parashtruesit të kërkesës, dhe gjithashtu ka ofruar një perspektivë të arsyeshme për sukses (shih, *inter alia*, *Civet kundër Francës* paragrafët 42-44 të aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 28 shtatorit 1999).
40. Megjithatë, kur një mjet juridik parashikohet me ligj, i takon parashtruesit të kërkesës të dëshmojë se mjeti juridik i paraparë me ligj është shteruar me të vërtetë ose për ndonjë arsye nuk ka qenë në dispozicion dhe ka qenë joefektiv në rrethanat e posaçme të rastit, ose ka pasur rrethana të veçanta për shkak të të cilave ai ose ajo kanë qenë të liruar nga kushti i shterimit të mjeteve juridike.
41. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kundër aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Themelore në Prizren CP. nr. 2739/2014, të 27 janarit 2020, ekziston mundësia e paraqitjes së ankesës si mjet i rregullt juridik kundër aktvendimit të kontestuar, siç ka theksuar Gjykata Themelore në udhëzimin e saj juridik "*kundër këtij aktvendimi, lejohet ankesa brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, dhe përmes kësaj gjykate*".
42. Gjykata më tej konkludon se më 10 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit duke kërkuar që ankesa e tij të aprovohet në tërësi dhe që Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren CP. nr. 2739/2014 i 27 janarit 2020, të anulohet.
43. Prandaj, Gjykata konstaton se procedurat në gjykatat e rregullta në lidhje me objektin e kontestit ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe palës kundërshtare janë ende në vazhdim dhe janë në pritje në Gjykatën e Apelit në bazë të ankesës së parashtruar nga parashtruesi i kërkesës dhe se parashtruesi i kërkesës nuk arsyeton se ankesa në Gjykatën e Apelit për ndonjë arsye nuk ishte në dispozicion dhe ishte joefektive në rrethanat e veçanta të rastit ose që kanë ekzistuar rrethana të veçanta për shkak të të cilave ai ose ajo ishte i liruar nga kushti i shterimit të mjeteve juridike.
44. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit duhet të deklarohet e papranueshme, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 22 korrik 2020, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi